

STATUTI
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
„Atlastech Digital“ SH.P.K

EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1
Themelimi

Sot më 20 Janar 2023

Themelohet Shoqëria tregtare **“Atlastech Digital”** sh.p.k si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” nga ortaku i mëposhtem:

- 1- **Elis Haruni** shtetas Shqiptare, lindur në Lushnje , i datëlindjes 17.01.1994 banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues Karte Identiteti J401170211.
- 2- **Ergest Osmëni** shtetas Shqiptare, lindur në Vlorë, i datëlindjes 08/07/1994 banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues karte Identiteti J40708115M.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

Kjo shoqëri fiton zotesinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, qëndër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqërisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

Neni 2
FORMA DHE EMERTIMI

2.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë asambleja e ortakeve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.

2.2.Emërtimi i shoqërisë është **“Atlastech Digital”** sh.p.k.



Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet Sh.p.k.

NENI 3 BAZA JURIDIKE

4. Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 4 SELIA

5.Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë.

Ne adresen: Rr. Lllaman Kaba, Pallati Alb Konsruksion, Shk.1, Ap 130, Kati i 8, Tirane, dhe mund te ndryshojë seline e saj me vendim të ortakeve.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË



Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë konsiston në kryerjen e të gjitha veprimtarive të pranuar dhe të ligjshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Projektim, modelim, prodhim, implementim dhe testim i softwareve. Zhvillim StartUp dhe trajnime në fushën e teknologjisë së informacionit. Shërbim konsulentësh për permisimin e procesit të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së softwareve (DevOps), mirëmbajtje dhe zhvillimi i sistemeve kompjuterike me disponueshmëri të lartë 24/7. Zhvillim i softwareve financiar. Menaxhim dhe administrim i sistemeve Operative dhe virtualizimit të infrastrukurës. Administrim i shtresës së mesme të logjikës së biznesit (middleware administration, docker, kubernetes, weblogic, tomcat). Konsulentësh për implementimin ose migrimin e infrastrukurës në Cloud. Mirëmbajtje dhe zhvillim serverash, sisteme operative dhe baze të dhenash. Analizë e bazave të mëdha të të dhënave "Big Data Analytics". Shitje License Software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to. Dhenie me qira e softwareve dhe software si shërbim. Shërbime të adoptimit dhe përshtatjes së softwareve dhe të bazave të mëdha të të dhënave "Big Data". Shërbime suportit dhe mirëmbajtje në fushën e sigurisë dhe teknologjisë së informacionit. Shërbime të konsulentëve në fushën e sigurisë së informacionit, teknologjisë së informacionit, analizës së bazave të mëdha të të dhënave dhe aktivitete të tjera të subjekteve private dhe publike. Shërbime trajnimit dhe edukimi në fushën e sigurisë dhe teknologjisë së informacionit. Shërbime të hostimit të bazave të mëdha të të dhënave "Big Data".

Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit; Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë; Zhvillim sistemesh migrimi; Përmirësim /upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suportit i përdorimit, trajnimit dhe auditimit Teknik/informatik për sistemet software; Konsulentësh në fushën Informatikës elektronike dhe telekomunikacionit; Shërbime informatike.

Shoqëria brenda hapsirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose terthorazi me objektin e



veprimtarise se saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te tjera, krijimin e siper marrjeve te reja dhe pjesmarrjen ne siper marrje te tjera , brenda dhe jashte vendit. Shoqeria mund te kryej edhe aktivite te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.

NENI 6 KOHËZGJATJA

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 7 TERRITORI

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI III AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI

NENI 8 FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

NENI 9 LIBRI I SHOQËRISË

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

NENI 10 KONFIDENCIALITETI

10.1 Ortaket e shoqerise si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 11



DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxiren nga Shoqëria dhe janë të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “SH.P.K”, si dhe emrin e administratorit.

NENI 12

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRANSFERIMI I TYRE

12.1 Kapitali themeltar i shoqërise do të jetë në **Leke**, 5 000 000 (pese milion lekë).

12.2 Kapitali themeltar është i ndarë në 2(DY) kuota.

12.3 Ky kapital themeltar i shoqërise është i zotëruar nga Ortaket si me poshte

- 1- **Elis Haruni** shtetas Shqiptare, lindur në Lushnje , i datëlindjes 17.01.1994 banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues Karte Identiteti J401170211, *zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë nominale 2 500 000* (dy milion e peseqinde *mijë* lekë) e barabarte me *50% te kapitalit te shoqërisë. Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të paksojë kuotat e kapitalit deri në kufinj të percaktuara nga ligji*
- 2- **Ergest Osmëni** shtetas Shqiptare, lindur në Vlorë, i datëlindjes 08/07/1994 banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues karte Identiteti J40708115M, *zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë nominale 2 500 000* (dy milion e peseqinde *mijë* lekë) e barabarte me *50% te kapitalit te shoqërisë. Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të paksojë kuotat e kapitalit deri në kufinj të percaktuara nga ligji*

Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të behët në përputhje me nenet 72- 75 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

12.5 Kapitali fillestar i shoqërise nuk është paguar.

Neni 13

Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit

- Pjeset e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.
- Transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar si trashgimni ose brenda familjes personave perfitues do ti behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuarderi ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar te behen lehtesisht te transferueshme.



- Ne raste mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve

Transferimi i kuotave te kapitalit themeltar te secilit ortak themelues, ne persona te tjere jo ortake te shoqerise do te behet vetem me miratimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast ortaku qe kerkon te largohet nga shoqeria, duhet te respektoje te drejten e parablerjes se kuotave nga ortaket themelues te shoqerise. Ne rast se kuotat e ortakut themelues jane te tilla qe kane nje çmim tregu te ndryshueshem do te merret si çmim i pranuar çmimi me i larte i shitjes, çmim i konfirmuar me garanci oferte te verifikueshem nga pjesmarresit e Asamblese se shoqerise. Në rast vdekjeje të ndonje prej ortakëve të shoqërisë trashëgimtarët e tij apo rast ndarje pasurore midis bashkeshortëve, subjektet perfitues sipas ligjit kane të drejtë të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit të shoqerise ose për vazhdimin e veprimtarisë sipas parashikimeve ne ligj nepermjet trashëgimise dhe pjesmarrjes se trashëgimtareve ligjore ne shoqeri apo bashkepjesmarrjes nga ndarja e pasurise bashkeshortore. Ortaket e kësaj shoqërie, mund të vendosë të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e shih të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 te Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

ORGANI DREJTUES
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 14
Asambleja e Ortakeve

Secili aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e mbledhjes së aksionarëve dhe mund të ketë një numër votash të barabarta me aksionet e kapitalit të zotëruar.

Një anëtar mund të përfaqësohet në një mbledhje të përgjithshme në bazë të një delegimi nga një partner tjetër, bashkëshorti ose personi tjetër i caktuar prej tij, me kusht që të autorizohet nga një prokurë.

Asambleja e ortakeve perbehet nga mbledhja e 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise. Ajo mblidhet me kerkesen e Administratorit. Gjithashtu secili prej ortakeve ka te drejte t'i paraqese Administratorit kerkese me shkrim per mbledhjen e asamblese te pergjithshme duke treguar ne te arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Ne rast se kërkesa refuzohet, ortaku kanë të drejtë të thërrase asamblenë dhe të caktojë çështjet e rendit të ditës.

Permbajtja dhe rendi i dites iu njoftohet ortakeve te pakten 7 dite perpara mbledhjes se Asamblese, ne rastin e shoqerise njoftimi iu behet te ditur te gjithë ortakeve themelues. Mbledhja quhet e vlefshme kur me nje nga menytrat e percaktuar ne ligj, eshte bere njoftimi i ortakeve te shoqerise (pjesmarresve te themeluesve), me konfirmim shkresor duke percaktuar

edhe rendin e dites se mbledhjes. Ne rast se pjesmarresit marrin pjese personalisht ata do te konsiderohen te njoftuar pavarsisht nese nuk ka konfirmim me shkrim. Pjesemarresi ne mbledhje mund te jete vete ose te perfaqesohet nga nje tjetër person te caktuar me Prokure perfaqesimi, duke patur te shprehur objektin e mbledhjes ne mbledhjen e Asamblese. Vendimet e asamblese te cilat merren me shumice te thjeshte do te jene te vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Vendimet te cilat merren me shumice te kualifikuar do te jene te vlefshme vetëm nëse jane te pranishem ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave. Do te meren me shumice te kualifikuar prej $\frac{3}{4}$ te kuotave pjesmarse vendimet per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Te gjitha vendimet e tjera do te meren me shumice te thjeshte. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:


- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të Shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kzsaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë ;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e pzdorimit.
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortaket. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket sipas nenit 84 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

NENI 16



KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e Ortakeve ka per kopetence :

Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçante të veprimtarisë.

-Te emeroje apo shkarkoje Administratorin e shoqërise, pronar ose jo pronar.

-Të jape ose jo pelqimin per caktimin e ekspertit kontabel nga Administratoret e shoqërise, i cili do te beje auditimin e vitit ushtrimor;

-Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj ;

-Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj ose te kerkuar nga çdo ortak ;

- Te jape ose jo miratimin per marrjen e çdo lloj huaje apo kredie bankare.

-Te jape ose jo miratimin per shtimin e kapitalit apo pakesimin e tij.

-Te vendose per miratimin ose jo te largimit te ortakut ne rast te shitjes se kuotave dhe zevendesimin e tij me nje person tjeter.

-Komptenca te tjera që parashikohen ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare"

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 17

ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

Kompania mund të administrohet nga administratori i vetëm ose administratorët e shumtë, të cilët mund të jenë persona fizikë të emëruar brenda komunitetit ose jashtë këtij komuniteti.

Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rimerimi. Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i një shoqërie tregëtare mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie.

Administratori të detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregëtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;

- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqesë raport të ortaku i vetëm apo të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqërisë është :

- 3- Z.Ergest Osmëni** shtetas Shqiptarë, lindur në Vlorë, i datëlindjes 08/07/1994 banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues kartë Identiteti J40708115M, me afat emërimi për 5 vjet me të drejtë riemërimi

NENI 17.1

Ne vecanti, për veprimtaritë e poshte listuara Administratori ka të drejtë të veprtoj vetëm pas marrjes së miratimit paraprak të Asamblese së Përgjithshme sipas përcaktimeve të Nenit 17.2:

a. Të kryej investime për shoqërinë të çfaredo natyre, në shumën më të madhë se 0.5% e xhirore të shoqërisë sipas Bilancit të vitit të fundit ushtrimor;

b. Të kryej blerje në shumën më të madhë se 1000 Euro (për transaksion), përveç blerjeve të cilat janë të lidhura ngushtë me funksionin e mbarevajtjes së aktivitetit kryesor të shoqërisë, të tilla si:

Blerje software;

Blerje pajisje të ndryshme informatike;

Blerje të materialit të ndryshëm konsumi të përditshëm.

c. Shperndatja e bonuseve të punësve.

d. Nenshkrimin e Kontrates së Punës së Administratorit si dhe çdo amendimi, aneksi apo modifikimi të saj.

Neni 17.2

Për ushtrimin e veprimtarive të listuara në Nenin 17.1, miratimi paraprak i Asamblese së Përgjithshme do të jepet përmes pjesëmarrjes së votimit në favor (PRO) të ortakëve që zotërojnë të paktën 60% të kapitalit të shoqërisë. Në rastet kur

kerkohet miratimi paraprak i Asamblese se Pergjithshme, Vendimi aprovues i kesaj te fundit duhet ti bashkengjitet Kontratave, Faturave apo cdo akti tjetër respektiv per ushtrimin e veprimtarive, në të kundërt ato do te konsiderohen sikur nuk kanë hyrë kurrë në fuqi dhe Administratorët mbajne përgjegjësi personalisht per ushtrimin e veprimtarive te kryera në kundërshtim me dispozitat e ketij neni

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI , DIVIDENTET

NENI 18

LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

NENI 19

BILANCI

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.
Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortaku i vetëm.
Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 20

DIVIDENTET

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe duke theksuar ekzistencën e fitimeve, mbledhja e aksionarëve përcakton pjesën e anëtarëve në formën e dividendëve mbi fitimet, në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit aksioner në kompani. Fitimet që do të shpërndahen midis anëtarëve në përpjesëtim me aksionet e kapitalit të kompanisë, përbëhen nga fitimi i vitit në të cilin janë zbritur shumat e rezervuara për fondin e domosdoshëm të aksioneve (5% të fitimeve) të secilit vit, derisa ky fond arrin vlerën 1/10 të kapitalit të kompanisë) dhe, nga ana tjetër, humbjet ose të ardhurat e mbajtura nga vitet e mëparshme zbriten ose rriten respektivisht.

MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 21

MBARIMI

22.1 Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsytet e parashikuara në ligj.

NENI 22

LIKUJDIMI

23.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi

gjendjen e aktivitet dhe pasivitet të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likuidimit, ortakët vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Mbas pagimit të kreditorëve ortakët i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT

NENI 23

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare, pasi të jete ezauruar mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirkuptim midis ortakëve.

NENI 24

DISPOZITA E FUNDIT

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.


Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Ortakët e shoqërisë.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë , me 20.01.2023

ORTAKET E SHOQËRISË

Elis Haruni

Elis Haruni


Ergest Osmëni

Ergest Osmëni 